

Vaktia e Ramazanit 2025/1446 h. për Siegen me rrethinë

Bashkësia Shqiptare IKRA-Siegen
Ju uron Muajin e bekuar të Ramazanit

Nijeti i agjërimit: Vendosa (bëra nijet) të agjëroj për Allahun e Lartmadhëruar.

Lutja e Iftarit: O Allah për Ty agjërova, Ty të besova, tek Ti gjej mbështetjen dhe me riskun Tënd bëj iftar.

Është mirë që iftari të bëhet sikurse e ka bërë Pejgamberi a.s., me hurma, e nëse nuk ka, me ujë.

Data	Ditët e ramazanit	Imsaku Syfyri	Lindja e diellit	Dreka	Ikindia	Iftari Akshami	Jacia	Teravitë
01.03.2025	1 e shtunë	05:23	07:06	12:45	15:36	18:15	19:45	20:30
02.03.2025	2 e diel	05:21	07:03	12:45	15:37	18:17	19:46	20:30
03.03.2025	3 e hënë	05:19	07:01	12:45	15:39	18:19	19:48	20:30
04.03.2025	4 e martë	05:17	06:59	12:45	15:40	18:20	19:50	20:30
05.03.2025	5 e mërkurë	05:14	06:57	12:44	15:41	18:22	19:52	20:30
06.03.2025	6 e enjte	05:12	06:55	12:44	15:42	18:24	19:53	20:30
07.03.2025	7 e premte	05:10	06:53	12:44	15:43	18:25	19:55	20:30
08.03.2025	8 e shtunë	05:08	06:50	12:44	15:44	18:27	19:57	20:30
09.03.2025	9 e diel	05:05	06:48	12:44	15:46	18:29	19:58	20:30
10.03.2025	10 e hënë	05:03	06:46	12:43	15:47	18:30	20:00	20:30
11.03.2025	11 e martë	05:01	06:44	12:43	15:48	18:32	20:02	20:30
12.03.2025	12 e mërkurë	04:59	06:42	12:43	15:49	18:34	20:04	20:30
13.03.2025	13 e enjte	04:56	06:39	12:42	15:50	18:35	20:06	20:30
14.03.2025	14 e premte	04:54	06:37	12:42	15:51	18:37	20:07	20:30
15.03.2025	15 e shtunë	04:51	06:35	12:42	15:52	18:39	20:09	20:30
16.03.2025	16 e diel	04:49	06:33	12:42	15:53	18:40	20:11	20:45
17.03.2025	17 e hënë	04:46	06:31	12:41	15:54	18:42	20:13	20:45
18.03.2025	18 e martë	04:44	06:28	12:41	15:55	18:44	20:15	20:45
19.03.2025	19 e mërkurë	04:42	06:26	12:41	15:56	18:45	20:16	20:45
20.03.2025	20 e enjte	04:39	06:24	12:40	15:57	18:47	20:18	20:45
21.03.2025	21 e premte	04:36	06:22	12:40	15:58	18:49	20:20	20:45
22.03.2025	22 e shtunë	04:34	06:19	12:40	15:59	18:50	20:22	20:45
23.03.2025	23 e diel	04:31	06:17	12:40	16:00	18:52	20:24	20:45
24.03.2025	24 e hënë	04:29	06:15	12:39	16:01	18:54	20:26	20:45
25.03.2025	25 e martë	04:26	06:13	12:39	16:02	18:55	20:28	20:45
26.03.2025	26 e mërkurë Nata e kadrit	04:24	06:10	12:39	16:03	18:57	20:30	20:45
27.03.2025	27 e enjte	04:21	06:08	12:38	16:04	18:59	20:32	20:45
28.03.2025	28 e premte	04:18	06:06	12:38	16:05	19:00	20:34	20:45
29.03.2025	29 e shtunë	04:16	06:04	12:38	16:06	19:02	20:36	

Dita e parë e Fitër Bajramit pritet të jetë: e diel 30 mars 2025

Namazi i Fitër Bajramit falet në ora 07:45

Kujdes, ditën e diel, 30 mars, ndryshon ora nga sistemi dimëror në sistemin veror (+60 minuta).

*** Marrë nga Kalendari i Diyanetit

Bashkësia Shqiptare IKRA-Siegen, Effertsufer 104, 57072 Siegen, Tel: 01578 4032788

Rregullat kryesore të agjërimit të Ramazanit (me shtojcat përkatëse)

Së pari: Domethënia e agjërimit.

“Agjërimi është lënia e ushqimeve, pijeve dhe marrëdhënieve seksuale, nga momenti i agimit të ditës deri në perëndim të diellit, që ka për qëllim adhurimin e Allahut.” Qëllimi i vetëm i agjërimit islam është fitimi i kënaqësisë së Allahut dhe përfitimet e tij fiziko-shpirtërore janë të panumërta.

Së dyti: Personi që duhet të agjërojë. Obligohet që të agjërojë Ramazanin plotësuesi i karakteristikave në vijim:

1. Muslimani. (Jomuslimani, nëse bëhet musliman në Ramazan, agjëron ditët që zë prej tij.)
2. I rrituri (që ka arritur moshën e pjekurisë seksuale) dhe i arsyeshmi (që nuk është i çmendur). (Fëmija nuk obligohet të agjërojë por është shumë mirë që mbi 7 vjeç të ushtrohet të agjërojë.)
3. I afti fizikisht për të agjëruar. (I sëmuri rëndë me sëmundje të pashërueshme, nuk agjëron por jep *fidje (shpagon agjërimin), ndërsa i sëmuri rëndë me sëmundje të shërueshme i agjëron para Ramazanit të ardhshëm ditët e paagjëruara. I thyeri në moshë (i/e vjetri/a), nëse dëmtohet nga agjërimi, nuk agjëron por jep fidje. I shtrënguari që të bëjë punë të rëndë në Ramazan, vendos të agjërojë para se të agjërojë dita dhe nëse puna e rëndë gjatë agjërimit e bën të bjerë në zanafillat e gjendjes kritike e çel atë ditë agjërimit dhe e agjëron më vonë.

Shënim: *Fidja (shpagimi i agjërimit): Për çdo ditë të paagjëruar nga Ramazani, i jepet të varfrit e pakta 750 gr dhe më e mira 1.5 kg oriz a ngjashëm nga ushqimet bazë të vendit / apo ekuivalenti në para, ose 1 vakt ushqim ngopës.

4. E paprekura nga gjërat që pengojnë agjërimin. (Gruaja të cilës i vijnë menstruacionet ose që është lehone gjatë ditës së agjërimit, nuk lejohet të agjërojë, por nëse pastrohet para agimit ajo vijon agjërimin dhe lahet pas agimit.)
5. Vendasi (në vendbanimin e tij). (Atij/asaj që udhëton mbi 80 km dhe qëndron në rrethana udhëtari deri në katër ditë pa ditët vajtje-ardhje, i lejohet të mos agjërojë dhe ditët e paagjëruara i agjëron para Ramazanit të ardhshëm.)

Së treti: Shtyllat e agjërimit

Shtylla e parë: Nijeti (Qëllimi).

Nijeti (qëllim i agjërimit) të Ramazanit bëhet që natën e parë të Ramazanit për të gjithë muajin, por më mirë është që nijeti të bëhet (në natën paraprake) për agjërimin e çdo dite të Ramazanit më vete. Që nijeti të jetë i saktë, mjafton që personi ta ketë në mend (në natën paraprake) se të nesërmen do agjërojë Ramazanin. Nijeti duhet të përsëritet sa herë që ndërpritet agjërimit.

*Shtylla e dytë: Mënjanimi i *prishësve të agjërimit.*

(1) Ngrënia a pirja e lëndëve ushqyese ose joushqyese dhe kapërdirja e ushqimit të mbetur nëpër dhëmbë, me dashje; (2) Raportet seksuale ditën në agjërim dhe ejakulimi (bërja xhunub) me dashje; (3) Menstruacionet dhe lehonja; (4) Vjellja me dashje; (5) Pirja e duhanit (6) Hapet (ilaçet me kokrra) dhe injeksionet ushqyese (serumet). Shënim: *Prishësit bazë të agjërimit janë: së pari: marrëdhëniet seksuale, së dyti: lëndët specifike shkarkuese (dalëse) trupore dhe së treti: lëndët hyrëse (në veçanti ato ushqyese) në bark (stomak).

Së katërti: Koha e agjërimit

- (a) Koha mujore e agjërimit të Ramazanit, llogaritet: (1) Duke u shikuar hëna e re e Ramazanit në perëndim të ditës 29 Shaban; (2) Nëse hëna e re nuk shihet, Ramazani fillon automatikisht pas perëndimit të ditës 30 Shaban;
- (b) Koha ditore e agjërimit, është: nga agimi (hyrja e sabahut) deri në perëndim (hyrja e akshamit).

Së pesti: Gjëra që nuk e prishin agjërimin:

- Ngrënia dhe pirja nga harresa, ose me mendimin: se s'ka gdhirë apo se dielli ka perënduar.
- Vjellja pa dashje, kapërdirja e ujit pa dashje gjatë abdesit dhe kapërdirja e pështymës a gëlbasës përbrenda gojës.
- Përdorimi i misvakut dhe furçes së dhëmbëve me kusht që të mos kapërdihen përbërësit e tyre lëndorë.
- Parfumi, si dhe pluhurat, erërat, aromat dhe tymi ekzistues i duhanit, nga të cilat njeriu s'mund të ruhet.
- Pompa (sprucuesja) e gazit për azmatikët dhe gargara a shfryrja e hundës gjatë abdesit, pa kapërdirë ujin.
- Heqja/mbushja e dhëmbëve, kurimi i plagëve, dhënia e gjakut në çdo sasi, hixhamja, dializa jo ushqyese, injeksionet jo ushqyese (penicilina, insulina, vaksina etj.) në lëkurë, muskul a vena, sondat e zorrëve a stomakut, lavazhi i kanalit urinar dhe lëndët që hyjnë nga ai dhe lavazhi i anusit dhe lëndët jo ushqyese që hyjnë nga ai.
- Ilaçet me pika nga veshët, sytë, goja a hunda dhe hapet nën gjuhë, nëse lëndët e tyre nuk e kalojnë gurmazin.
- Qëndrimi në ambiente të kondicionuara, larja tërësore ose e pjesshme e gjymtyrëve të trupit pa e kapërdirë ujin.
- Ejakulimi ditën në ëndërr. (I bëri xhunub natën, i cili gdhihet pa u larë, e vijon agjërimin dhe lahet pas agimit.)

Gjithashtu:

- Rekomandohet vonimi i syfyrit (ngrënies) deri në kufi të agimit dhe shpejtimi i iftarit (ushqimit) sapo të perëndoj dielli. Iftari më i mirë janë hurmat, pastaj uji dhe pastaj çdo ushqim dhe pije e lejuar.
- Agjëruesi që s'ka me se ta çel agjërimin, nuk e thith gishtin etj., por e bën nijetin e çeljes së agjërimit me zemër.
- Agjëruesi lejohet ta prish agjërimin për domosdoshmëri, si: shpëtimi i të mbyturit etj. dhe e kompenson më vonë.
- Muslimani/a krahas obligimit të agjërimit, gjatë Ramazanit i kryen të gjitha obligimet e tjera të Islamit, sidomos pesë vaktet e faljes së namazit në kohën dhe formën e caktuar dhe po kështu e frenon veten nga haramet.
- Gruaja shtatzënë / mëkuese lejohet të mos agjërojë nëse ka frikë serioze të sigurt për shëndetin e vet apo foshnjës.
- Femra me istihada (hemorragji tjetër veç menstruacioneve dhe lehonisë) duhet të agjërojë. (E tilla nuk agjëron nëse hemorragjia është në atë nivel që ajo e ka të sigurt se me këtë hemorragji agjërimi do ta mundojë shumë.)

Përgatiti: Hoxhë Altin Torba tel: 02 71 23 374 374 dhe mobil: 01 57 84 032 788 (Kjo fletë nuk lejohet të hidhet apo poshtërohet sepse përmban emrin e Zotit dhe të tjera shenjtëri islame. Pasi të mos e përdorni më, ose digjeni ose jepjani një personi që di si të veprojë me të.)

*** Marrë nga Kalendari i Diyanetit

Bashkësia Shqiptare IKRA-Siegen, Effertsufer 104, 57072 Siegen, Tel: 01578 4032788